



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701524/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandojmë shpejtimin e gjykimit të dosjes gjyqësore me Nr.31018-02123-86-2016 akti, dhe datë 09.05.2016 me paditës ankusin I. B. nga Tirana.*

Drejtuar : **Z.Kastriot SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijëni : **Z.Ilia BUSHO**
Lagja Nr.1, Shtëpi Private, Shkozë

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e saj datë 20.11.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetësja R. B. nga Tirana ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me objekt konstatim i pavlefshmërisë relative të aktit administrativ datë 04.08.2015, për mbyllje pensioni nga DRSSH Tiranë për bashkë shortin të saj I. B.

Ankuesja R. B. nga ana e saj na sqaron se Gjykata Administrative e Shkallës së Pare Tiranë, me vendimin e saj me Nr.1257 datë 16.03.2016 ka vendosur si vijon :

Pranimin e kërkesë- padisë të paditësit I. B., shfuqizimin e vendimit datë 04.08.2015 për mbylljen e pensionit nga DRSSH Tiranë. Kundra këtij vendimi gjyqësor ka paraqitur ankim DRSSH Tiranë, e cila ka kërkuar prishjen e tij dhe dosja gjyqësore tani ndodhet e regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me Nr.31018-02123-86-2016 akti, datë 09.05.2016, dhe nga Relatorja e caktuar me short Zj.E.Metalia nuk është planifikuar akoma gjykimi i saj.

Ankuesja na shkruan se paditësi ndodhet i sëmurë nga gjendja shëndetësore dhe DRSSH Tiranë padrejtësisht i ka mbyllur pension me argumenta të padrejta se aktet lexohen me vështirësi në një kohë që Gjykata e faktit ka argumentuar se ankuesi I. B. përfitimin e pensionit si punonjës nëntoke e ka përfituar në bazë të ligjit, dhe padrejtësisht ana e paditur i ka mbyllur atij marrjen e pensionit.

Në këto kushte dhe duke patur parasysh kushtet dhe rrethanat ekonomike e familjere dhe ato shëndetësore jo të mira të ankuesit I. B., mendojmë që në rastin konkret të ndërhyhet nga ana jonë me rekomandim duke e konsideruar këtë rast ***si rast i veçantë dhe që ka lidhje me shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, për një gjykim të drejtë dhe publik dhe brenda afateve të arsyeshme parashikuar dhe garantuar nga***

dispozitat e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nga kërkesat e nenit 6 të KEDNJ.

Në këtë drejtim mendojmë se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, duhet të ketë parasysh faktin se ankuesi I. B. e ka fituar të drejtën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi me vendimin gjyqësor Nr.1257 datë 16.03.2016 të Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Tiranë, dhe faktin tjetër se pala e paditur DRSSH Tiranë, ka vendosur pezullimi dhe mbylljen e dhënies së pensionit shtetasit I. B. nga data 04.08.2015.

Në këtë drejtim ne mendojmë se duhet mbajtur parasysh edhe fakti se neni 3 i Ligjit me Nr.49/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjet administrative", ndër parimet e gjykimit administrativ parashikon sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësit për krijimin e këtyre gjykatave. Ligji nga ana e tij gjithashtu synon thjeshtimin e procedurave, me objekt zgjidhja e mosmarrëveshjeve administrative si dhe garantimin e një mbrojtje efektive të të drejtave të subjektit dhe interesave të ligjshme, të personave sipas kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe kërkesat e parashikuara nga neni 6/1 i K.E.D.NJ.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së RSH, thuhet se:

"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, nga administrata publike", dhe kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku përcaktohet se :

" Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

"Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të detyrave dhe lirive", dhe për të gjitha këto arsye, dërgohet ky

R E K O M A N D I M :

1. Të shikohen të gjitha mundësit ligjore, për shpejtimin e gjykimit të dosjes gjyqësore me Nr.31018-02123-86-2016 akti, datë 09.05.2016, nga ana juaj që ka lidhje me paditësin I. B, sa më shpejtë, në të ardhmen.

2. Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi nga ana juaj, lutemi të na njoftohet me shkrim institucioni i Avokati i Popullit, brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI